



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 9579 /2019

Data: 08.10.2019

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverballi nga mbledhja e -IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 26.09.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emërgjencë), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i buxhetit të komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2021-2022.
3. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
4. Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2020.
5. Miratimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.
6. Miratimi i propozim vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.
7. Miratimi i propozim vendimit për caktimin e kriterëve dhe shpalljen e konkursit për komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.
8. Raporti i performancës për vitin 2018.
9. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- në faqen katër të diskutimi im të shtohet fjala udhëzimin administrativ i vitit 2015 dhe 2018.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Miratimi i buxhetit të komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2021-2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- ju e dini që buxheti është më i vogël për shkak të vendimit të ish kryeministrit z.Isa Mustafa që për komunat e vogla ka përfunduar afati tre vjeçar. Sa i përket propozimeve të qytetarëve mbi 90 % ishin kubëzime nëpër zona të ndryshme, kanalizimi dhe asfaltime të cilat i kemi përfshirë me kode të përbashkëta.

Shabi Rexhallari thekson:- bazuar në Qarkoret Buxhetore (QB) 2020/01 dhe 2020/02 për komunat mbi kufijtë final të përcaktuar nga Ministria e Financave (MF), Komuna e Hanit të Elezit ju dërgon Projekt-Buxhetin për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2021-2022. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 është në shumë prej 2,742,095 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2021 janë në shumë prej 2,846,397 € dhe për vitin 2022 janë në shumë prej 2,958,963 €. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2020 sipas pikës dy të këtij propozim vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,424,230 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 88.41%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 317,865 € apo 11.59%. sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe mëditje 1,687,983 €, mallra dhe shërbime 303,236 €, shpenzime komunale 60,000 €, subvencione dhe transfere 61,104 € dhe shpenzime kapitale 629,772 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sabrije Krasniçi thekson:- a është përfunduar asfaltimi i rrugës Dermjak-Neqafç sepse është planifikuar edhe në vitin 2020 për shkak se unë mendoj që do të përfundon në vitin 2019 ky projekt.

Akif Shkreta thekson:- për vitin 2020 buxheti është planifikuar në shumë prej 2,742,095 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2021 janë në shumë prej 2,846,397 € dhe për vitin 2022 janë në shumë prej 2,958,963 €, kurse në vitin 2019 buxheti ishte më i lartë. Kërkoj sqarim për këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- projektet nuk ka pasur nevojë për me i përsëritur nëse janë kryer në këtë vit. Buxheti duhet të jetë në përputhshmëri me planifikimet e kryetarit të komunës. Shqetësimet e mia ishin sepse investimet janë shkuar në mënyrë të gabuar për shkak se më e rëndësishme ka qenë çështja e ujit.

Sabedin Hasallari thekson:- propozoj që për vitin 2020 të vendosen muret mbrojtëse dhe kanalet e hapura në projektet që janë bërë me kupëza betoni sepse për shkak të një muri shumë të vogël projekti nuk po përfundon deri në fund. Propozoj që për vitin 2020 të bëhet rregullimi i krojeve ose burimeve publike.

Florim Shkreta thekson:- a është mundësi që me u ditur projekti që do të realizohet në zonën urbane apo në zonën rurale sepse të gjitha rrugët kanë emërtim.

Rufki Suma thekson:- ka raste gjatë shtrimit të rrugës me kubëza betoni po paraqiten rrethanat që edhe muret mbrojtëse me i rregulluar dhe është mirë të jetë si kod i veçantë. Sa i përket krojeve publike në fshatin Paldenicë e kemi rregulluar dhe është e nevojshme edhe krojet tjera me u rregulluar. Rruga Dermjak-Neqafç përfundon në këtë vit dhe si kod ka mbetur për shkak se kemi bërë ridestinim të mjeteve dhe ende nuk është miratuar në Qeveri dhe nëse nuk miratohet patjetër e kemi me i përfunduar disa projekte që i kemi në vitin tjetër. Me Ministrinë e Infrastrukturës kemi pasur marrëveshje për rregullimin e rrugës së Dermjakut që bëhet fjalë në ato pjesët të cilët janë dëmtuar, ndërsa Dermjak –Neqafç duhet të hiqet. Në vitin 2016 ish kryeministri z.Isa Mustafa që për tri vite të ardhshme ta lëshon një buxhet shtesë për komunat të cilat i kanë më pak se 22 000 banorë dhe në kuadër të atyre komunave ka përfutur Hani i Elezit mbi 300 000 € dhe për vitin 2020,2021 dhe 2022 është buxhet i rregullt e jo shtesë. Projektet i kemi planifikuar si të përgjithshme por në kllapa e kemi përcaktuar fshatin të cilin planifikojmë me rregulluar. Çështja e ujit e kemi lënë që të funksionalizohet kompania “Bifurkacioni” dhe CDI-ja e cila ka premtuar që do ta kryen dhe ende nuk kanë bërë ndonjë veprim konkretë dhe për këtë arsye si komunë nuk kemi mundur me bërë asgjë sa i përket çështjes së ujit.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e ujit nuk them që nuk është marr seriozisht në teori por ekziston në çdo planifikim por seriozisht nuk është marr çështja e ujit. Shpimet të cilat janë bërë në afërsi të rezervarit janë bërë para disa muajve dhe asnjë efekt nuk e kanë dhënë. Projektet po shndërrohen më shumë në çështje politike se sa ekzekutive diçka sepse nuk mund të bëhen projektet aty për aty por duhet të planifikohen dhe buxhetohen por më mirë është planifikohen dhjetë rrugë kemi me i shtruar dhe i afatizon brenda një apo tri vite pastaj kalon në projekte të tjera, e jo në tre mandate projektet e njëjta duke filluar kubëza, asfalt, ujë 1000 €. Mendoj që nuk janë politika parimore që vetëm me i përsëritur sepse ne po e dimë që për qytetarin nuk është kurrë perfekt jeta e tij nëse ne e ndalim dikund një projekt por me i afatizuar projektet për një plan të cilin e kemi bërë.

Florim Shkreta thekson:- rrugët të cilat i shtroni me kubëza a bazoheni me ndonjë rregullore sepse e shohë që keni filluar edhe oborret me i shtruar me kubëza betoni.

Teuta Shkreta thekson:- trotuari i cili është rregulluar prej shkollës fillore deri te Uji i Thart është bërë shumë mirë por është mirë që të bëjmë një trotuar me ndriçim të cilin do ta shfrytëzojmë për ecje apo rekreacione.

Kryesuesi thekson:- kanalizimi në fshatin Pustenik në cilin vit parashihet me u rregulluar për shkak se gjithë e dinë që ka filluar me u bërë ndërtime dhe biznese.

Rufki Suma thekson:- do të fillon pjesë e tjetër e trotuarit nga Dheu i Bardhë deri te shkolla fillore dhe pasi të rregullohet fusha e futbollit e cila është duke u bërë afër shkollës së mesme “Dardania” dhe ajo pjesa deri te ambulanca do të rregullohet rrugë vetëm për shëtitore. Jemi në biseda me Bankën Botore për rregullimin e shtratit të lumit Lepenc dhe në kuadër të shtratit të lumit një pjesë do të bëhet trotuar. Sa i përket çështjes së kanalizimit në fshatin Pustenik nëse pronarët e pronave private deklarohen që e i lëshojnë pronat e tyre për rregullimin e kanalizimit komuna e rregullon kanalizimin.

Shabi Rexhallari thekson:- rregullimi i krojeve publike është i planifikuar, kurse për propozimin i cili ishte për rregullimi e mureve mbrojtëse dhe hapjen e kanaleve të hapura dhe mjetet financiare do të merren prej bashkë investimeve.

Mefail Suma thekson:- shpenzimet kapitale të cilat parashihen te shërbimet publike mbrojtja civile, emergjenca janë të parapara në shumë prej 40 000 €. Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve janë të parapara në shumë prej 40 000 €. Kërkoj sqarim më në detale për këtë çështje. Shpenzimet kapitale për vitin 2020 do të jenë në shumë prej 629,772 €, kurse në fund figuron në shumë prej 439,000 €, ndërsa të tjerat nuk figurojnë.

Shabi Rexhallari thekson:- te investimet kapitale tabela 4.2 kufijtë e financimit i cakton Ministria e Financave për të gjitha komunat. Investimet kapitale për vitin 2020 Ministria e Financave i ka paraparë për çdo komunë dhe komuna e Hanit të Elezit do të ketë 629,772 €, për vitin 2021 do të kemi investime kapitale në shumë prej 641,756 €, kurse për vitin 2022 do të kemi investime kapitale në shumë prej 677,632 €. Shërbimet publike dhe emergjenca është program buxhetorë të cilin Ministria e Financave e ka përcaktuar që është në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe shuma 40 000 € është nënprogram i kësaj.

Teuta Shkreta thekson:- a është planifikuar të bëhet furnizimi me uniforma për stafin mjekësorë për shkak se tri apo katër vite nuk jemi furnizuar.

Rufki Suma thekson:- kjo mund të bëhet prej mallrave dhe shërbimeve.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z.Sabedin Hasallari e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim buxhetin e komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2021-2022; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2020 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021-2022

3. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- komisioni i cili është formuar për hartimin e planit të punës së kuvendit ka mbajtur mbledhje dhe ka bërë harmonizimin e pikave të rendit të punës për vitin 2020. Nëse keni ndonjë vërejtje apo propozim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- po më duket se po shkelet ligji për shkak se të njëjtin plan pune është paraparë informatë dhe në mbledhjen e parafundit prej njëmbëdhjetë pikave të rendit të punës gjashtë prej tyre ishin informata. Në bazë të cilës rregullore përgatitet plani dhe a është në bazë të rregullores së punës apo në bazë të ligjit për shkak se në rregullore dhe në ligj nuk parashihen informatat? Kompetencat dhe përgjegjësitë e kuvendit janë që të shqyrton materialin që ia ofron ekzekutivi i komunës. Potencohet informatë mbi suksesin e nxënësve sepse ne nuk kemi qasje të diskutimit në te, as me debatuar por vetëm informohemi, mirëpo pse nuk bëhet shqyrtimi i informatës që së paku ta japim mendimin tonë. A kemi të drejtë me bërë debat kur të paraqitet ndonjë informatë dhe nëse kemi të drejtë është shqyrtim. Unë jam që t'i ikim termit informatë.

Bajrush Laçi thekson:- informatat dhe raportet dallojnë sepse raporti është më ndryshe prej informatës për shkak se informatat zakonisht kanë dalur si analogji se realisht nuk parashihen si informata por gjatë punës së procedurave kanë dalur të nevojshme me i paraqitur në kuvende, kështu që mundet të mbetet edhe shqyrtimi i informatës. Informata do të ketë çdo herë në kuvend edhe pse ndoshta nuk është paraparë me ligj.

Mehmet Ballazhi thekson:-unë mendoj që ka një dallim në shqyrtim dhe informatë dhe kur të ipet informata na informon ekzekutivi kurse për me shqyrtuar është çështje tjetër. Këtu është e paraparë për me informuar kuvendin për ndonjë punë të cilën e kanë kryer dhe kemi të drejtë me diskutuar informatën të cilën dërgon ekzekutivi i komunës.

Akif Shkreta thekson:-informata prezantohet në kuvendin e komunës nga ekzekutivi dhe pastaj kuptohet që ka me pasur diskutime dhe propozime.

Mefail Suma thekson:- në asamble kam qenë edhe më parë dhe asnjëherë nuk ka qenë rendi i ditës i ngarkuar me gjashtë informata.

Kryesuesi thekson:- për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës ndihmesë ka dhënë Demosi i cili e ka pasur një këshilltarë i cili ka bashkëpunuar me MAPL-në për harmonizimin e rregulloreve dhe ligjeve. Informatat të cilat janë propozuar në mandatin 2009-2013 nuk i kemi pasur dhe në vitin 2014-2018 kanë hyrë në plan të punës në mënyrë që për me kontrolluar ekzekutivin e komunës dhe ekzekutivi më shumë për me u përgjigjur te kuvendi duhet që anëtarët e kuvendit të kërkojnë informata. Informatat është me u njoftuar kuvendi dhe në momentin që shqyrtohet informata ju mund ti parashtroni vërejtje ekzekutivit të komunës.

Bajrush Laçi thekson:- informata nuk miratohet kurse raporti miratohet dhe Ligji për Vetqeverisje Lokale i ka disa gabime që edhe ju anëtarët e kuvendit keni qenë nëpër trajnime. Neni 40 potencon se kryesuesi thërret mbledhje dhe duhet të bëhet thirrje por shumica e komunave e kanë bërë ftesë për shkak se e kanë vërejtur se thirrjet janë nëpër gjykata. Neni 39 i parashih informacionet për të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit të komunës që çdo anëtarë i kuvendit ka të drejtë të kërkon informacione dhe në mes atyre informacioneve hartohet informata.

Shabi Rexhallari thekson:- Zyra Kombëtare e Auditimit ka miratuar një rregullore të re që i obligon të gjitha organizatat buxhetore për me raportuar dy herë në vit për adresimin e rekomandimeve që duhet të jetë në muajin prill dhe në tetor, raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020

4. Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Laçi thekson:- rregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat dhe si drejtori i kemi dhënë propozimet tona. Gjatë hartimit të rregullores është harruar taksa për subjektet që merren me kontrollimin teknik të automjeteve në shumë prej 200 €. Debat publik është mbajtur me qytetarë dhe janë dhënë disa propozime. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- kërkoj sqarim për certifikatat të cilat prej një euro është ngritur në dy euro se a jeni bazuar në legjislacion që e keni bërë këtë ngritje?

Edon Curri thekson:- ndryshimet janë bërë te disa certifikata të reja të cilat kërkohen prej bashkatdhetarëve të cilët jetojnë jashtë shtetit. Me rregulloren e re është e lejuar që mund të bëhet ngritja e taksës dhe për atë kemi propozuar.

Mefail Suma thekson:- mjetet të cilat inkasohen prej këtyre certifikatave në çfarë forme merren, a lëshohet vërtetim për këto mjete dhe a mund të keqpërdoren.

Edon Curri thekson:-mjetet financiare nuk mund të keqpërdoren për shkak se llogariten prej sistemit dhe në fund të javës deponohen në xhirollogari të komunës.

Florim Shkreta thekson:- pacientët të cilët kontrollohen në ambulantë disa kategori janë të liruar sipas kësaj rregullore , mirëpo a ka pasur raste që pacienti ka kryer shërbime mjekësore e nuk ka paguar dhe si është vepruar nëse ka pasur ndonjë rast të tillë.

Medina Imishti thekson:- participimi në shëndetësi është i rregulluar në bazë të udhëzimit administrativ dhe në fund janë të gjitha kategoritë të cilat janë të liruar nga taksa në bazë të ligjit për shëndetësi. Qytetarët të cilët janë rast social dhe të cilët e kanë gjendjen e vështirë materiale tentojnë me paguar , mirëpo ka edhe ndonjë pacientë i cili e ka gjendjen e mirë financiare dhe nuk paguan për shërbimet.

Kryesuesi thekson:- propozimi i z. Florim Shkreta është kyçja ilegale në sistemin e ujësjes për personat fizik propozoj të jetë 200.00 €, kurse personat juridik 1000.00 €.

Refet Kalisi thekson:- propozimi i ekzekutivit është që për personat fizik 500 €, kurse personat juridik 1000.00 €.

Florim Shkreta thekson:- propozimin e kam dhënë në mënyrë që zyrtarët me pasur më lehtë për me zbatuar për shkak se ka pasur raste dhe nuk e kanë dënuar për shkak se dënimi ka qenë i lartë. Më mirë është që dënimet të jenë më të vogla por me u zbatuar se sa dënimet me qenë të larta dhe mos me u zbatuar.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z.Florim Shkreta e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte 10 kundër 4 për. Në mbledhje të KPF-së z.Mehmet Ballazhi ka propozuar që taksa për regjistrimin e automjeteve të hiqet dhe të njëjtin propozim e ka dhënë edhe z.Florim Shkreta në debat publik.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse nuk parashihet me ligj dhe me udhëzim administrativ kjo taksë propozoj që të hiqet, dhe nëse është me udhëzim administrativ së paku të jetë minimumi i kësaj takse.

Shabi Rexhallari thekson:- propozoj që të mbetet kjo taksë për shkak se është e përcaktuar me udhëzim dhe të gjitha komunat në Kosovë e kanë. Përmes kësaj takse janë edhe dy apo tri taksa të tjera që komuna mund t'i inkason.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z. Mehmet Ballazhi dhe të z.Florim Shkreta e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte 10 kundër, 3 për 1 abstenim. Propozimi i z.Betim Bushi taksa për pagesën e mbeturinave për ekonomitë familjare propozoj nga 5 € të jetë 3 € .

Refet Kalisi thekson:- si drejtori nuk mund të bëjmë zbritje për shkak se nuk mund t'i mbulojmë shpenzimet e kompanisë.

Florim Shkreta thekson:- a është marr parasysh kërkesën të cilën e ka parashtruar z.Sabedin Hasallari për qytetarët të cilët janë ndëshkuar në mënyrë jo të drejtë?

Refet Kalisi thekson:- qytetarët të cilët nuk i paguajnë mbeturinat i paralajmërojmë që duhet të kryhet pagesa.

Florim Shkreta thekson:- qytetarët të cilët nuk kanë nënshkruar pagesë për mbeturina i favorizoni dhe mendoj që kjo nuk është e drejtë.

Akif Shkreta thekson:- i kemi tri kategori të qytetarëve dhe atë qytetarë të cilët kanë lidhur kontratë dhe nuk paguajnë, qytetarë të cilët kanë lidhur kontratë e paguajnë dhe qytetarë të cilët nuk kanë lidhur kontratë. Për qytetarët të cilët kanë lidhur kontratë dhe nuk paguajnë është ligji, mirëpo problemin e kemi me qytetarët të cilët nuk kanë lidhu kontratë dhe komuna duhet ta krijoj një ekip që të bënë një verifikim dhe ata qytetarë me i liru prej pagese dhe si projekt me u implementuar si tërësi që do të thotë mbeturinat tu merren dhe kriteret të përcaktohen se cilët qytetarë duhet të lirohen prej pagese.

Kryesuesi thekson:-propozimin e z.Betim Bushi e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte 10 kundër 4 për. Propozimi z.Faruk Berisha hedhja e kafshëve, shpezëve në hapësira publike për persona fizik propozoj të jetë 100 € kurse personat juridik 300 €.

Refet Kalisi thekson:- në rregullore është propozuar që për persona fizik 25 € personat juridik 100 €.

Rufki Suma thekson:- unë mendoj që dënimi duhet të jetë më i madh për shkak se bëhet fjalë për kafshët e ngordhura dhe propozoj që për persona fizik 100 €, kurse personat juridik 300 €.

Kryesuesi thekson:- propozimin e kryetarit të komunës e hedh në votim; rezultati i votimit 11 për 3 kundër. Propozimin i z. Nustret Shiti importimi i kafshëve nga një vend tjetër në territorin e Komunës së Hanit të Elezit Personi fizik 1000 € Personi juridik 3000.00 €.

Refet Kalisi thekson:- në rregullore kemi dhënë propozimin si drejtori dhe mendoj të jete propozimi siç e kemi dhënë. Kjo taksë ka për qëllim ndëshkimin e atyre personave të cilët i sjellin qentë endacak në komunën tonë.

Akif Shkreta thekson:- termin importim duhet ta modifikojmë për shkak se ka kuptim tjetër.

Florim Shkreta thekson:- edhe në mbledhje të Komitetit për Komunitete e kemi pasur këtë diskutim dhe mënyra se si është shkruar është e pakuptueshme por është mirë të shënohet nëse e ka kuptimin për qentë endacak.

Mefail Suma thekson:- ne të cilët jetojmë nëpër fshatra dhe në Ferizaj, Prizren apo Gjakovë e blejmë një gjedh dhe e sjellim në shtëpi por a me u dënuar për këtë. Është mirë të apostrofohet për shkak se është potencuar në shumë.

Akif Shkreta thekson:- më mirë është që drejtorja ta definon termin kurse ne e miratojmë.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj që për personin fizik të jetë 200 € kurse për personin juridik 500 € dhe propozimin në fjalë e hedh në votim, rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër. Propozimin e z.Mehmet Ballazhi që taksa për certifikatat e vendbanimit, statusit martesore, shtetësisë dhe të bashkësisë të zbriten prej 2 € në 1€. Propozimin e hedh në votim 10 kundër 3 për 1 abstenim. Në tërësi e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2020

5. Miratimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- pas konfirmimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal se disa nga dispozitat e kësaj rregullore nuk janë në harmoni me Udhëzimin Administrativ. Nuk është vetëm komuna e Hanit të Elezit por edhe shumica e komunave i kanë marr këto rekomandime për shkak se Kolegjiumi i Zyrtarëve të Transparencës gjatë hartimit të kësaj rregullore i ka pasur disa mangësi të vogla. Propozimet janë përcjell me material nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për 2 kundër.

U MIRATUAN PROPOZIM NDRYSHIMET PËR RREGULLOREN PËR TRANSPARENCË

6. Miratimi i propozim vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresë ju ka drejtuar kryetarëve të komunave që i ka obliguar për themelimin e këtij komiteti. Ne e kemi krijuar një data bazë për personat me aftësi të kufizuara dhe janë afër 67 persona me aftësi të kufizuara. Është zgjedhur kryetarja e Hendikosit por jemi duke u munduar edhe një menaxher me zgjedhë në mënyrë me funksionalizuar në kuadër të komunës së Hanit të Elezit. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- mendoj që duhet të hynë në rregullore dhe në statut të komunës edhe ky komitet.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

7. Miratimi i propozim vendimit për caktimin e kriterëve dhe shpalljen e konkursit për komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuar.

Kryesuesi thekson:- kriteret për shpalljen e konkursit janë të parapara me udhëzim administrativ lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:-me udhëzim administrativ janë përcaktuara kriteret dhe besoj që komisioni do ta bënë përzgjedhjen e personave adekuat.

Kryesuesi thekson:- paneli është i njëjtë për zhvillimin e procedurave. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR CAKTIMIN E KRITERËVE DHE SHPALLJEN E KONKURSIT PËR KOMITETIN KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.

8. Raporti i performancës për vitin 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- është raport i cili vjen për çdo vit prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe si komunë jemi 82.46 %. Prej kësaj performance kemi fituar grandin prej Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në shumë prej 60 000 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- në material i keni të gjitha të dhëna sa i përket fillimit të viti të ri shkollorë. Në këtë vit i kam shënuar me një tabelë të veçantë shkollën fillore “Ilaz Thaçi” dhe arsyeja ishte që ju me i parë se sa është numri i nxënësve në fshatin Seçishtë dhe Krivenik . Në fillim të vitit kemi biseduar me kryetarin e komunës për me i kombinuar për shkak numrit të vogël të nxënësve për shkak se kjo nuk llogaritet zonë rurale, mirëpo në biseda me kryetarin e komunës mbet që edhe në këtë vit me mundur me gjet formë se si ta mbajmë atë shkollë që mos me i transferuar nxënësit në Han të Elezit por unë kërkoj ndihmën e ekzekutivit dhe legjislativit që të marrim hapa ose ti kthejmë nxënësit e Lagjes së Re atje ose me i kombinuar klasët dhe nëse bëhet kombinimi i klasave nxënësit do të shkojnë në Han të Elezit. Në KPF kam potencuar që janë dy rrugë njëra është që nxënësit me i kthyer atje që besoj që është e pa realizueshme sepse prindërit nuk pranojnë por kam marr skenime se sa nxënës i kemi të familjeve të Seçishtës të cilët janë në fushë e që mund t'i kthejmë atje dhe afërsisht janë të barabartë që nuk është një shifër shumë e madhe. Klasa e parë i ka njëmbëdhjetë kurse atje kanë mbetur tetë nxënës , në klasën e dytë në fshatin Seçishtë janë dhjetë kurse që e vijnë mësimin në Han të Elezit janë katër, në klasën e tretë në Seçishtë janë gjashtë ndërsa në Han të Elezit tetë. Nuk është ndonjë numër i madh që mund të mbetet shkolla atje për shkak se për çdo vit është duke rënë numri i nxënësve.

Akif Shkreta thekson:- informatës për vitin e ardhshëm duhet t'i bashkëngjitet raporti i inspektoratit dhe i sanitarisë. Kemi mungesë të teksteve shkollore të klasës së tetë dhe të nëntë në nivel të komunës. Funksionalizimi i kabineteve duhet të merret parasysh dhe të jenë më funksionale. Asistenti për nxënësit me nevoja të veçanta është një pikë e mirë dhe është tu funksionuar. Nxënësit të cilët udhëtojnë jashtë Hanit të Elezit në shkollat profesionale udhëtimin ta kenë pa pagesë. Sa i përket paraleleve të ndara fizike në Seçishtë dhe në Krivenik kjo është problem i rregulluar me ligj dhe unë mendoj që nuk është mirë të veprohet me mësim të kombinuar sepse dështon dhe shkon në mbylljen e shkollave. Propozoj që të shtrihet diskutimi sepse ne kemi drejtor të shkollave, mësimdhënës, kryetarë të këshillave të fshatrave, këshill të prindërve, këshill drejtues të shkollës dhe të gjithë këto akterë të cilët e përbëjnë mësimin në komunën tonë të mblidhen dhe të diskutojnë në bashkëpunim me këshillin e prindërve që me ardhur me një përfundim dhe vendim në mënyrë që me u kryer kjo punë.

Mefail Suma thekson:- në vitin 2017 kanë qenë 47 paralele në shkollën fillore, kurse në vitin 2019 kanë rënë në 45 paralele. Kërkoj sqarim për këtë çështje. Unë mendoj që nuk është në kompetencën e kuvendit për me i mbyllur shkollat por ajo kompetencë është e arsimit. Është mirë me biseduar me banorët e Lagjes së Re që fëmijët me i dërguar në shkollë në fshatin Seçishtë në mënyrë që mos me u mbyllur ajo shkollë.

Florim Shkreta thekson:-unë mendoj që duhet t'i ndihmohet drejtorit në këtë çështje por duhet të shterren të gjitha mundësitë që konsideroj që nuk është bërë. Nxënësit e fshatit Krivenik pavarësisht se është numër i vogël është dashur me i dërguar në shkollën e fshatit Seçishtë dhe të punojmë në atë drejtim me prindërit që nxënësit të cilët i përmendi drejtori me mundur me kthyer përsëri në shkollën e fshatit Seçishtë. Ndoshta shkelet ligji mirëpo ligji shkelet edhe në Han të Elezit për shkak se 40 nxënës mësojnë me një klasë dhe është mirë mos me u mbyllë shkolla.

Hanumshahe Dibrani thekson:- nxënësit të cilët udhëtojnë për në shkollën profesionale në Ferizaj të ju paguhet udhëtimi për shkak se në komunën tonë nuk ka drejtime të tilla. Është e domosdoshme të ju ndihmohet për shkak se ata e kryejnë shkollën dhe kontribojnë në komunën tonë. Kompania "Elita Turs" ka bërë ngritjen e çmimit për bileta nga 0.70 € bileta është bërë 1 €.

Isni Bushi thekson:- është mirë me biseduar me prindërit për shkak se çdo klasë e ka nga një prind përfaqësues po ashtu edhe me përfaqësuesit e fshatrave dhe drejtorin e shkollës me bashkëpunuar për me gjetur një formën sepse kuvendi nuk mund të merr vendim për me mbyllur shkollën.

Menduh Vlasi thekson:- unë mendoj se janë shterrur mundësitë për shkak se kam mbajtur mbledhje me prindërit e fshatit Krivenik në vitin e kaluar dhe në këtë vit dhe ju kam treguar se nuk ka cilësi në mësim me klasë të kombinuara. Në fshatin Seçishtë isha në vitin e kaluar dhe banorët nuk duan me dëgjuar për këtë çështje dhe kam biseduar me prindërit individualisht dhe askush nuk pranon. Sa i përket nxënësve në shkollat profesionale ju tash e miratuat buxhetin dhe askush nuk propozoj për me ndarë mjete financiare për me i kryer shpenzimet e udhëtimit për nxënësit të cilët mësojnë në shkolla profesionale. Nuk duhet të krahasohet me komunën e Kaçanikut për shkak se e kemi mbyllur shkollën profesionale në Han të Elezit para disa viteve për shkak të cilësisë së dobët, mirëpo nëse i ndajmë mjetet për në Ferizaj duhet t'i ndajmë edhe për në Prishtinë apo në Malishevë për shkak se nuk janë të gjitha shkollat profesionale në Ferizaj. Sa i përket zvogëlimit të paraleleve është për shkak rënies së numrit të nxënësve dhe dy paralele janë shuar njëra në fshatin Laç tjetra në fshatin Rezhancë. Kuvendi e di që nuk merr vendim por edhe drejtoria nuk merr vendim por drejtoria merr vendim sipas ligjit për me i kombinuar klasët. Kam biseduar që nxënësit e fshatit Krivenik për me mësuar në shkollën e Seçishtës por në biseda me banorët kanë kërkuar që nëse transferohen më mirë është të shkojnë në Han të Elezit dhe ne si drejtori nuk e kemi atë të drejtë. Sa i përket furnizimit me tekste shkollore sipas informacioneve që kam në Prishtinë janë hapur procedurat për furnizim me tekste shkollore për shkak se nuk është problem vetëm i komunës sonë por edhe në komunat e tjera. Në shkolla që ka numër të vogël të nxënësve nuk lejohet investimi në ato shkolla dhe nëse investohet në shkollën e Seçishtë dhe Krivenikut është jashtë ligjore.

Rufki Suma thekson:- unë propozoj që të formohet një komision dhe në atë komision të përfshihen persona që kanë të bëjnë me arsim, këshilli i prindërve, kryetarë të këshillave të fshatrave, komiteti për komunitet pra të bëhet një rreth më i gjerë për me i diskutuar gjërat dhe nëse nuk ka zgjidhje vendosë grupi punues dhe me përcjellë propozimin te ekzekutivi që për vitin 2020-2021 me marr vendim.

Akif Shkreta thekson:- unë nuk mendoj që janë shterrur mundësitë dhe ideja është që ta bisedojmë këtë çështje në mënyrë që mos të shkohet me një vendim të njëanshëm të kuvendit ashtu siç i kanë marrur disa komuna dhe pastaj tu e shfuqizuar gradualisht sepse kanë bërë shkelje ligjore. Të bisedohet me akterët e arsimit kjo çështje dhe çdo vendim që merret është më i pranueshëm.

Mehmet Ballazhi thekson:- si është marr vendim për paralelen në fshatin Laç dhe për paralelen në fshatin Hunel?

Menduh Vlasi thekson:- edhe te Laç edhe te Hunel është bërë në bashkëbisedim me prindërit dhe ata janë bindur që me i dërguar në Han të Elezit nxënësit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- kërkoj që të rregullohet uji te objekti i Qendrës për Punë Sociale.

Refet Kalisi thekson:- informacion nuk ka pasur për çështjen e ujit për te Qendra Social dhe në momentin që jam informuar është rregulluar.

Besarta Suma thekson:-më herët kam parashtruar pyetje për çështjen e zebrave dhe kryetari pat potencuar se nëse nuk i bënë kompania “Bektelenka” do ti bënë komuna. A është bërë diçka në këtë drejtim.

Florim Shkreta thekson:- sa i përket përgjigjeve me shkrim më është kthyer përgjigjja për çështjen e pagesës të cilën nuk e kam kërkuar. Kërkoj informacion me shkrim për prejardhjen e parcelës së z.Sami Brava. A jeni bazuar dikund që keni bërë përzgjedhjen e punëtorëve më të dalluar dhe si ka shkuar mënyra? Kërkoj sqarim prej drejtorisë së shërbimeve publike për çështjen e taksës që biseduam më lartë.

Rufki Suma thekson:- sa i përket zebrave deri më tani kemi pritur që do ti bënë Ministria e Infrastrukturës , mirëpo deri tani nuk e kanë kryer dhe nuk ka ndonjë përgjigje që do ta kryejnë në këtë vit dhe nëse nuk do ta kryejnë do ti shikojmë mundësitë që komuna me i bërë. Në çdo institucion bëhet përzgjedhja e punëtorit më të mirë dhe gjatë zgjedhjes merren performancat e punëtorit se çfarë sjellje ka , a e ka kryer punën dhe i njëjti punëtorë nuk ka të drejtë me u përsëritur për çdo vit.

Florim Shkreta thekson:- punëtorët të cilët janë zgjedhur më të mirë shihet që ishin në fazën fillestare dhe nuk e kanë mbërri fazën për me u dalluar që është më i miri dhe për atë parashtrua pyetje se a jeni bazuar me ndonjë rregullore që këta punëtorë i keni përzgjedhur më të dalluar. Mendoj që nuk jeni bazuar për shkak se nuk përshtatet me kualifikimin dhe kohën kur është punësuar dhe datat e punësimit që i bien me kuptuar që po bëhemi një grupacionë dhe po dallohemi por nuk është në rregull.

Sabedin Hasallari thekson:- kërkesë kam prej banorëve të Lagjes së Re që me i vendosur disa shporta të mbeturinave në rrugë. Pllaka përkujtimore e cila është vendosur ja ka shtuar krenarinë qytetit por është një gabim te bashëkvendasi im dhe duhet të jetë Hasan S Hasallari.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket rrjetit kabllorë përgjigje i kemi dhënë z.Florim Shkreta por nuk është i kënaqur.

Florim Shkreta thekson:- përgjigje më është dhënë kompania që i ka bërë marrëveshjet me KEDS-in, mirëpo unë kam kërkuar përgjigje me shkrim taksën për shtrirjen e rrjetit kabllorë. Kërkojë që si drejtori t’i trajtoni qytetarët të barabartë dhe këtë taksë që e keni në rregullore duhet ta zbatoni. Përsëri kërkoj përgjigje me shkrim për taksën për shtrirjen e rrjetit kabllorë për shkak se ju i keni sjellë marrëveshjet që kompania i ka me KEDS-in për shfrytëzimin e shtyllave elektrike dhe kjo pjesë nuk më intereson por më intereson shtrirja e kabllave.

Kryesuesi thekson:- përgjigje të kanë dhënë dhe nëse parasheh që ka shkelje janë organet e tjera dhe mund të vazhdoni për shkak se drejtorja mendon që është te zbatuar taksën. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:22

Procesmbajtësi

Azri Bushi

